

DEKLARATË PUBLIKE

Oponencë ndaj Propozimeve për Hartën e Re Gjyqësore për Shqipërinë

Në situatën e vakancave shqetësuese të krijuara në sistemin tonë gjyqësor si dhe për të përmbushur objektivat e parashikuar në legjislacionin e ri të sistemit të drejtësisë, grupimi i organizatave të shoqërisë civile që ka nënshkruar këtë deklaratë publike vlerëson në parim, si një proces shumë të rëndësishëm, ri-organizimin e gjykatave dhe kompetencave të tyre tokësore. Ky proces i njohur ndryshe si, harta gjyqësore, vlerësojmë se mbart një rëndësi kyç për rritjen e aksesit, cilësisë dhe reduktimin e kostove për qytetarët në marrjen e drejtësisë dhe në respektim të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor.

Përmbledhje Ekzekutive e Oponencës Ligjore

Propozimi, hartimi dhe miratimi i Hartës Gjyqësore është detyrim ligjor që institucionet përgjegjëse duhet ta kishin përmbushur shumë kohë më parë. Vonesat e pajustificuara do të kishin vlerë nëse produkti final të ishte një vendimmarrje cilësore, e konsultuar, strategjike dhe me garanci për efektivitet e integritet në ofrimin e dhënien e drejtësisë.

Ndryshe nga këto pritshmëri, organizatat e shoqërisë civile nënshkruese të kësaj letre të hapur vlerësojnë se procesi i konsultimit të hartës së re gjyqësore duhet të kishte filluar që në fazën e ideimit të saj. Ne kërkojnë nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Ministrisë së Drejtësisë që ky proces konsultimi në këtë fazë të mos jetë formal, por të garantojë mundësi reale dëgjimi dhe reflektimi.

Konsultimi më i gjërë me qytetarët gjithashtu është i domosdoshëm, duke patur parasysh kushtet sociale – ekonomike të vendit tonë. Harta e re gjyqësore duhet të marrë për bazë nevojat dhe rrjedhimisht të konsultohet drejtpërsëdrejti me këshillat bashkiakë dhe komunitete qytetare, disa prej të cilave ndodhen më në vështirësi, sidomos me kategori të veçanta sociale si minoriteti Rom dhe Egjiptian, gratë në nevojë, të rinjtë dhe të miturit, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, komuniteti LGBTI, qytetarët në pamundësi ekonomike, shtetasit e privuar nga liria, etj. Me rëndësi të veçantë do të ishte edhe vlerësimi i shpërndarjes dhe përqëndrimit të popullatës në njësitë administrative të secilës bashki (kriteri demografik), në analizën e munguar për mënyrën e shpërndarjes së gjykatave në kuadër të këtij ri-organizimi.

Në aspektin metodologjik, treguesit e marrë në vlerësim nga grupi i punës nuk janë të detajuar, konçizë dhe të qartë sa i takon përzgjedhjes dhe përcaktimeve të tyre. Kalkulimi i qartë i distancave dhe kohës së udhëtimit janë indikatorë të rëndësishëm për qytetarin për të aksesuar shërbimin gjyqësor. Ky tregues nuk është përcaktuar objektivisht sipas kushteve të vendit tonë, cilësinë e rrugëve dhe transportit rrugor, mjetet e munguara të transportit në disa prej zonave të thella rurale, si dhe mundësitë ekonomike të kufizuara të qytetarëve për të përdorur transportin publik dhe/ose privat. Për një vend, i cili sipas të dhënave të INSTAT, 49% e popullsisë jeton në minimumin jetik,¹ tregues të tillë janë thelbësor për t'i dhënë kuptim të drejtës dhe parimeve kushtetuese të barazisë përpara ligjit.

1

Pamundësia e referuar në raportin e vlerësimit të hartës së re, për të marrë në konsideratë tregues që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e çështjeve sipas kategorive të tyre, analizimin e stokut, etj, mund të ishte adresuar qoftë dhe pjesërisht, nëse do të pilotohej pjesërisht bazuar në të dhënat që ofron sistemi i menaxhimit ICMIS, në ato gjykata ku është i aplikueshëm. Gjithashtu, shtimi i personelit të nevojshëm administrativ për mbledhjen dhe përpunimin manual të të dhënave në ato gjykata që nuk ofrojnë sistemin e duhur të menaxhimit dhe përpunimit elektronik, mund të vlerësohej si një opsion i zbatueshëm në fazën e hershme të ideimit të hartës së re gjyqësore. Pavarësisht të qënurit të ndërgjegjshëm mbi situatën e pazakontë me të cilën sistemi gjyqësor në vendin tonë po përballet, vlerësojmë se nuk mund të realizohen propozime “sakrifikuese” në dëm të interesit publik të qytetarëve, për aspekte të cilat mund dhe duhet të ishin menaxhuar më herët në kohë.

Opsioni i krijimit të disa degëve të gjykatave, përkohësisht, si rezultat i kufizimeve infrastrukturore të godinave të gjykatave, nuk analizohet në raport me indikatorë të tjerë si nevoja e aksesit të qytetarëve në raport me infrastrukturën, kushtet sociale ekonomike, etj. Në tre gjykata që sugjerohen të shkrihen, përkatësisht në Lushnjë, Kavajë dhe në Krujë propozohet krijimi i degëve të përkohshme, megjithë është e paqartë deri në ç’masë rekomandohet nga ana e Grupit të Punës ky opsion dhe përse nuk është vlerësuar një opsion edhe për rrethe të tjera gjyqësore që propozohen të shkrihen. Gjithashtu, kur analizohet vlera që kanë degët e gjykatave, grupi i punës ka vlerësuar impaktin e tyre duke marrë si model disa prej shteteve me standart ekonomik shumë herë më të lartë se vendi ynë si Suedia, Holanda dhe Portugalia.

Sa i përket shkrirjes së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë, vlerësojmë se nga ana e grupit të punës nuk është mbajtur në konsideratë numri i shtetasve të privuar nga liria që vuajnë dënimin pranë IEVP Fushë Krujë. Duke u bazuar në sistem përlllogaritës të distancës (Google Maps) rezulton se një shtetasi që vuan dënimin pranë IEVP Fushë - Krujë i duhet të udhëtojë dyfishin e distancës kilometrike nëse Gjykata e Krujës shkrihet me Gjykatën e Durrësit (për çështjet që janë në kompetencë të saj). I njëjti shqetësim vlen edhe për propozimin për shkrirjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, i cili nuk merr në konsideratë numrin e shtetasve të privuar nga liria të akomoduar në IEVP Kosovë (Lushnje) dhe si ndikon ky ri-organizimin në ndjekjen e çështjeve të tyre të cilat janë duke u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje.

Ndër propozimet më shqetësuese të grupit të punës për hartën e re gjyqësore është shkrirja e Gjykatave të Apelit në një Gjykatë Kombëtare të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Koha maksimale e përlllogaritur nga grupi i punës për të mbërritur pranë kësaj Gjykate Kombëtare të Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, prej 4 orësh dhe 46 minutash nga Konispoli (skaji më i largët i përlllogaritur në rang vendi), vlerësojmë se është një tregues që nuk është llogaritur mbi baza realiste, pasi nuk merr në konsideratë objektivisht kohën që i duhet një qytetari për të udhëtuar me anë të mjeteve të transportit publik. Nuk është aspak e drejtë që nën moton e reformimit të sistemit të drejtësisë, qytetarët (veçanërisht grupet në nevojë) të vazhdojnë të vuajnë si taksapagues dhe përdorues të gjykatave, pasojat ekonomike që sjell shkrirja e gjykatave të apelit. Referenca që grupi i punës ka bërë për ekzistencën e një gjykate të vetme të Apelit Administrativ dhe atë të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, nuk merr në konsideratë faktin se kriteret përcaktuese nuk mund të analizohen në mënyrë të njëjtë, për shkak të kompetencës lëndore dhe rrjedhimisht natyrës

(Duhet theksuar se sipas INSTAT, rreziku për të qenë i varfër në Shqipëri (varfëria relative) gjatë periudhës 2017-2018 është 23.4% (http://www.instat.gov.al/media/6543/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-2017-2018_.pdf), ndërkohë që sipas Bankës Botërore sa i përket vlerësimit të përballueshmërisë së vendeve me pandeminë Covid-19, 35.6% e shqiptarëve jetojnë nën kuotën 5.5 dollarë/ditë).

së çështjeve që gjykon secila prej këtyre Gjykatave. Grupi i Punës duhet të mbajë gjithashtu në konsideratë edhe efektet që ka prodhuar shqyrtimi i çështjeve gjyqësore në nivel vetëm të një gjykate apeli administrativ. Nisur nga vetë Raporti i KLGJ-së², *backlog* i Gjykatës Administrative të Apelit referuar të dhënave fillim i vitit 2020 ka shënuar 12.810 çështje të mbartura. Në këtë propozim, grupi i punës bazohet gjithashtu tek modele të vendeve të tjera si psh, për Suedinë dhe Moldavinë, ku reduktimi i numrit të gjykatave është realizuar në mënyrë graduale dhe jo në nivele kaq drastike. Vendet fqinje si Bosnje-Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia kanë një numër më të lartë gjykatash apeli, ndërkohë vende si Danimarka apo Finlanda kanë një numër më të ulët gjykatash, por një standart ekonomik shumë herë më të lartë se vendi ynë. Rrjedhimisht, propozimi për shkrirjen e 6 Gjykatave të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në një të vetme, përbën një hap i cili nuk është analizuar dhe studiuar në mënyrë objektive dhe të gjithëanshme, mbi bazën e disa kriterëve influencues, të cilat mund të cilësohen si dytësore për qendrat e zonave urbane, por për kategori të caktuara njerëzish në nevojë apo për banorët në zonat rurale, janë kritere primare dhe thelbësore.

Propozimi për shkrirjen e gjashtë gjykatave administrative të Shkallëve të Para në rang vendi, duke krijuar në këtë mënyrë vetëm dy Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, me seli në Tiranë dhe Lushnjë nuk reflekton numrin dhe territoret e gjykatave të tjera të propozuara në hartën e re gjyqësore (në mënyrë analoge me ato të juridiksionit civil). Shkrirja e Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Durrës dhe Korçë, duke ia kaluar kompetencat tokësore të këtyre gjykatave, Gjykatës Administrative Tiranë sjell rritjen e shumëfishtë prej rreth 60.84% të kohës maksimale të udhëtimit. Një qytetari në Korçë i rritet në masën 128.2% koha maksimale e udhëtimit për të kërkuar zgjidhjen e çështjeve gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky organizim i ri i gjykatave administrative të shkallës së parë do të përkeqësojë aksesin në drejtësi, duke mos e favorizuar qytetarin në raport me vendbanimin, kushtet infrastrukturore të transportit dhe kushtet sociale ekonomike, në të cilat gjendet.

Sa më sipër, Reflektimi i grupit të punës mbi nevojën e rishikimit të raportit të vlerësimit për hartën e re gjyqësore, bazuar në sugjerimet dhe këndvështrimet e përcjella në këtë opinion nga disa organizata të shoqërisë civile, vlerësojmë se është i domosdoshëm për të shmangur rrezikun e kolapsit, sa i takon aksesit në drejtësi.

1. Sugjerime/vlerësime parimore lidhur me metodologjinë e përdorur në dizenjimin e Hartës së Re Gjyqësore:

a. Për shkak të rëndësisë që ka harta në drejtim të aksesit në drejtësi si dhe kohës së hershme në të cilin ka nisur dizenjimi i saj, kemi mendimin se procesi i konsultimit që në fazën e ideimit dhe më pas shtjellimit të hartës së re gjyqësore do të kishte qenë më efektive për sa i takon cilësisë së kontributeve që mund të ofroheshin dhe mundësisë për të reflektuar dhe për t'i adresuar ato. Për akte të tilla me interes të lartë për publikun, të cilat cilësohen si politika publike në kuptim të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, procesi i konsultimit nuk duhet të jetë kurrësesi formal por duhet të garantohet mundësi reale për të dëgjuar grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile, duke argumentuar njëkohësisht me transparencë, për shkallën e reflektimit të konsultimeve të bëra dhe dhënien e kundër-argumentave për sugjerimet të cilat nuk janë marrë në konsideratë.

Duke qenë se impakti i hartës ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë tek qytetarët, është gjithashtu e nevojshme që procesi i konsultimit nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe

² Faqe 82

Ministrisë së Drejtësisë të realizohet edhe në formën e dëgjësive publike, duke patur parasysh pasojat që mund të shkaktohen kundrejt interesit të publikut të gjerë. Sa kohë që pasojat e zbatimit të kësaj harte të re gjyqësore do të sjellin efekte në “xhepat” e qytetarëve, vlerësojmë procesi i konsultimit me qytetarët dhe njerëzit në nevojë duhet të karakterizohet nga elementët që e bëjnë atë të thjeshtë dhe të kuptueshëm për publikun e gjerë, si dhe duke qenë më i shtrirë në aspektin territorial por edhe në kohë. Ky sugjerim vjen si nevojë edhe e problematikave që kanë rezultuar me hartat gjyqësore në vendet që janë marrë si model reference, ku psh në Portugali, një nga shqetësimet kishte të bënte me faktin se publiku nuk u pajis me informacion të mjaftueshëm, gjë që shkaktoi ngatërresa se ku dhe kujt duhet t’i drejtoheshin çështjet gjyqësore.

Në mënyrë të veçantë, edhe kontributi i Njësive të Qeverisjeve Vendore do të ishte i rëndësishëm përgjatë këtij procesi konsultativ, pasi këto përbëjnë një hallkë kyç që përballet në përditshmërinë e punës së tyre, me ankesat dhe shqetësimet e qytetarëve, duke përfshirë ato që prekin kushtet sociale apo ekonomike në të cilat ata jetojnë.

b. Në aspektin metodologjik, treguesit e marrë në vlerësim nga grupi i punës nuk janë të detajuar, konçizë dhe të qartë sa i takon përcaktimeve të tyre. Konkretisht, për treguesit “distanca dhe koha e udhëtimit” nuk del e qartë se cilat janë vlerat ekzakte të përcaktuara për secilën nga këto të dhëna. Nëse për distancën nuk jepet asnjë e dhënë se cili është maksimumi i largësisë së lejuar ndërmjet gjykatës dhe vendbanimit të qytetarit (njësisë administrative të caktuar), për treguesin “koha e udhëtimit”, caktohet në mënyrë të shprehur indikator prej 2 orësh, si një element proporcional i përcaktuar në referencë të analizës së realizuar në raportin British HM Courts & Tribunals Service. Në përmbajtjen e këtij raporti konstatohet se kjo kohëzgjatje vlerësohet si e arsyeshme për të aksesuar gjykatën, por duke përdorur transportin publik. Ndërkohë në draft pranohet se gjatë hartimit të tij nuk janë administruar të dhëna për udhëtimin me transport publik nga njësitë administrative të secilës Bashki drejt gjykatave të ri-dizenjuara që kanë kompetencën përkatëse territoriale.

Përcaktimi i distancave dhe kohës së udhëtimit janë indikatorë të rëndësishëm për qytetarin për të aksesuar shërbimin gjyqësor dhe rrjedhimisht edhe për të gjithë korpusin e lirive dhe të drejtave të tij, kur këto ndërvaren nga aksesin në drejtësi.

Duke iu referuar treguesit të kohës së udhëtimit, jemi të mendimit se nga ana e grupit të punës ky element duhej të ishte përcaktuar qartazi, duke marrë në shqyrtim kushtet e vendit tonë, cilësinë e rrugëve dhe transportit rrugor, mjetet e munguara të transportit në disa prej zonave të thella rurale, si dhe mundësitë e kufizuara të qytetarëve për të përdorur transportin publik dhe/ose privat. Të dhëna të tilla vlerësojmë se duhej të ishin marrë parasysh, për të vlerësuar realisht dhe objektivisht aksesin e qytetarëve në shërbimet gjyqësore, konform situatës faktike në territorin e vendit tonë.

Në kuadër të transparencës së procesit, do të përbënte interes të shtuar për ne edhe njohja me proceset e metodologjinë që është ndjekur për të çuar në zhvillimin e treguesve të përdorur nga grupi i punës për këtë detyrë.

c. Sa i përket treguesit “për ngarkesën e punës dhe nevojën për gjyqtarë”, krahas numrit të çështjeve të reja dhe kategorizimit të tyre si të lehta apo komplekse për t’u zgjidhur, të cilat janë përdorur për të llogaritur ngarkesën mesatare të ponderuar për një gjyqtar gjatë një viti, do të ishte e vlefshme të përpunoheshin edhe të dhëna të tjera, të cilat ndikojnë në masë të shtuar në ngarkesën e punës së gjyqësorit, në raport me kushtet e vendit tonë. *Jo domosdoshmërisht kjo nënkupton që këto elementë të jenë të rëndësishme për vendet e tjera europiane apo ato të rajonit.* Kohëzgjatja e çështjeve sipas kategorive të tyre, analizimi i stokut, si dhe numri i seancave të zhvilluara mesatarisht për lloje të caktuara gjykimesh,

mund të ishin tregues të vlefshëm për t'u marrë në konsideratë dhe përfshirë në këtë proces të vlerësimit të gjendjes për ri-shpërndarjen e gjykatave.

Kjo mangësi vërehet edhe në raportin e vlerësimit të grupit të punës, i cili e referon si mungesë nevojën e një liste më të detajuar të llojeve të çështjeve dhe supozimeve më të detajuara të ngarkesës relative për lloje të ndryshme çështjesh. Nisur nga sistemet ekzistuese të menaxhimit të çështjeve, grumbullimi manual i këtyre të dhënave është i pamundur që të realizohet. Sikurse dihet, një nga objektivat për menaxhimin efektiv të ngarkesës së gjykatave varet nga ndërtimi dhe funksionimi i një sistemi menaxhimi të përmirësuar elektronik, bashkëkohor dhe të unifikuar, me kapacitet statistikor të shëndetshëm të mbështetur në metodologjinë e CEPEJ-it. Të vetëdijshëm për kufizimet e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave lidhur me çështjet dhe ngarkesën e gjyqtarëve, kemi mendimin se këto shqetësime mund të ishin adresuar disi nga ana e grupit të punës, nëse do të pilotohej pjesërisht vlerësimi i ngarkesës bazuar në të dhënat që ofron sistemi i menaxhimit ICMIS, në ato gjykata ku është i aplikueshëm. Gjithashtu, shtimi i personelit të nevojshëm ndihmës për mbledhjen dhe përpunimin manual të të dhënave në ato gjykata që nuk ofrojnë sistemin e duhur të menaxhimit dhe përpunimit elektronik, mund të vlerësohej si një opsion i zbatueshëm në fazën e hershme të ideimit të hartës së re gjyqësore.

Pavarësisht të qënurit të ndërgjegjshëm mbi situatën e pazakontë me të cilën sistemi gjyqësor në vendin tonë po përballet, vlerësojmë se nga ana e grupit të punës nuk mund të realizohen propozime "sakrifikuese" në dëm të interesit publik, për aspekte të cilat mund dhe duhet të ishin menaxhuar më herët në kohë, me synim përmbytjen e një prej objektivave kyç të reformës në drejtësi që synon akses efektiv të qytetarëve në organet e drejtësisë. Njëkohësisht, kjo qasje do të shërbente pozitivisht për një analizë më objektive të ngarkesës së gjyqtarëve, duke kontribuar në ofrimin e zgjidhjeve të përshtatshme si dhe në terma më afatgjatë dhe të qëndrueshëm për hartën e re gjyqësore, në kushtet e vendit tonë.

d. Në raportin e vlerësimit, grupi i punës argumenton se ligji nr. 98/2016 e lejon KLGJ-në të krijojë degë të përhershme ose të përkohshme gjykatash për gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Degët e gjykatave gjykojnë çështje civile dhe penale, të cilat gjykohen nga një gjyqtar i vetëm, ndërsa degët e përhershme do të përbëhen prej jo më pak se 3 gjyqtarë, me një ngarkesë mesatare vjetore jo më të vogël se ngarkesa mesatare vjetore për gjyqtar në të njëjtën shkallë gjykimi në tre vitet e fundit. KLGJ-ja ka autoritetin të miratojë rregullat dhe procedurat e funksionimit të degëve dhe shpërndarjen e gjyqtarëve në to.

Grupi i Punës ka nxjerrë në pah disa ndryshime për ligjin aktual, që do të jenë të nevojshme nëse degët e gjykatave do të jenë një zgjidhje e realizueshme. Sipas vlerësimit të bërë, pasja e degëve nuk do të kishte kuptim, nëse ato nuk do të kenë kompetencë për të gjykuar çështje urgjente. Megjithatë, përkundrajt nevojës së identifikuar për ndryshime ligjore, ato nuk evidentohen në raportin e vlerësimit, se në ç'drejtim kushtëzon krijimi i këtyre degëve ndryshimet në legjisllacionin ekzistues.

Sipas grupit të punës, në rastet kur gjykata e krijuar nga shkrirja nuk i përmbush plotësisht standardet për akomodimin e gjyqtarëve të caktuar sipas organikës, atëherë janë marrë në konsideratë mbajta e përkohshme ose e përhershme e një dege gjykate aty ku ndodhej ish-gjykata. Kur flitet për opsionet e degëve, janë propozuar që këto degë të krijohen përkohësisht si rezultat i kufizimeve infrastrukture, të gjykatave të cilat bashkohen me gjykatat e shkrija dhe nuk analizohet veçmas nevoja e aksesit në raport me infrastrukturën, kushtet sociale ekonomike, dinamikën e numrit dhe llojit të çështjeve në këto gjykata të cilat shkrihen etj. Në tre gjykata që sugjerohen të shkrihen, përkatësisht në Lushnjë, Kavajë dhe në Krujë propozohet krijimi i degëve të përkohshme, megjithatë, është e paqartë deri në

ç'masë rekomandohet nga ana e Grupit të Punës ky opsion dhe përse nuk është vlerësuar një opsion edhe për rrethe të tjera gjyqësore që propozohen të shkrihen.

Gjithashtu, kur analizohet vlera që kanë degët e gjykatave, grupi i punës ka vlerësuar impaktin e tyre duke marrë si model disa prej shteteve të analizuara në raport si Suedia, Holanda dhe Portugalia. Në dy shtetet e para, me kalimin e kohës shumica e degëve rezultojnë të jetë eliminuar. Në Suedi, një prej arsyeve ishin vështirësitë dhe kostot e larta financiare që lidhen me menaxhimin e degëve të veçanta, të cilat ishin më të mëdha se ndikimi pozitiv. Në Portugali po konsiderohet rihapja e disa prej degëve dytësore të mbyllura më parë, kryesisht prej shqetësimeve mbi aksesin në drejtësi dhe infrastrukturën e dobët. Më tej, edhe kjo analizë krahasimore me vendet e tjera për efikasitetin ose jo të degëve, nuk është aktualizuar dhe vendosur në kontekstin shqiptar, pasi nuk merr në konsideratë kushtet infrastrukturore të rrugëve, situatën e transportit publik, dhe kushtet sociale ekonomike të banorëve në Bashkitë respektive. Nëse psh, një degë gjykatë në Suedi është eliminuar për shkak të kostos së lartë dhe sepse palët ndërgjyqëse nuk kanë patur probleme në aksesin e një gjykatë më të largët, kjo duhet parë në raport me nivelin ekonomik, transportin dhe infrastrukturën rrugore në shtetin Suedez si dhe atë të sistemit elektronik që ja mundëson shtetasve Suedezë ta aksesojnë gjykatën dhe në mënyrë elektronike. Njëkohësisht, kjo ndërvaret edhe me zhvillimin kulturor dhe nivelin e përdorimit të teknologjisë së informacionit nga popullsia në Suedi dhe Shqipëri.

e. Referuar ecurisë së deritanishme të procesit të vettingut (*duke marrë parasysh të dhëna si ritmi i gjykimin të çështjeve, numri i seancave, kohëzgjatja e çështjeve, ankimet, vendimmarrja në të dyja shkallët e procesit*) si dhe bazuar në një analizë probabiliteti të projektuar për vijueshmërinë e këtij procesi, të hartuar nga ekspertë statisticien, harta e re gjyqësore e propozuar mund të kishte marrë në konsideratë edhe këtë indikator për mënyrën se si projektimi në vijim i procesit të vettingut do të ndikonte në ngarkesën e gjykatave të ridizenuara në vijimësi. Pavarësisht se ky është një proces me afat të përcaktuar, nevoja për adresimin e pasojave në dhënien e drejtësisë është prezente dhe kërkon adresim institucional nga strukturat e gjyqësorit.

f. Me rëndësi të veçantë është vlerësimi i shpërndarjes dhe përqendrimit të popullatës në njësitë administrative të secilës Bashki (kriteri demografik), në analizën për mënyrën e shpërndarjes së gjykatave në kuadër të këtij ri-organizimi. Nisur nga të dhënat e publikuara nga INSTAT, më 1 Janar 2021 rezultojnë se Qarku i Gjirokastrës ka % më të ulët të popullsisë (rreth 2.1% të popullsisë së përgjithshme), ndjekur nga Qarku i Kukësit (2.6% të popullsisë së përgjithshme). Por nga analiza e realizuar nga Grupi i Punës është vërejtur se qendrat e këtyre qarqeve janë shndërruar në qendra të godinave të gjykatave pranë të cilave do të vendosen dhe gjykatat e shkrija.

2. Sugjerime/vlerësime për propozimet konkrete të ri-organizimit të ri të sistemit gjyqësor

g. Sa i përket shkrirjes së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë, vlerësojmë se në analizën e realizuar nga ana e grupit të punës nuk është mbajtur në konsideratë numri i shtetasve të privuar nga liria që vuajnë dënimin pranë IEVP Fushë Krujë, ndërkohë që aty referohet për efekt të të dhënave edhe IEVP Krujë, për të cilën më herët, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve/Ministria e Drejtësisë ka komunikuar mbylljen e këtij institucioni. Megjithatë, duke ju referuar vetëm IEVP Fushë – Krujë, ku shtetasit e privuar nga liria janë në ndjekje të proceseve të tyre penale, veçanërisht shtetasit e paraburgosur, vlerësojmë se shkrirja e gjykatës së Krujës mund të krijonte problematika në drejtim të aksesit të këtyre shtetasve. Kjo, duke mbajtur në konsideratë dhe mjetet e kufizuara logjistike e burimet njerëzore që administrata e sistemit të burgjeve ka për shoqërimin e

shtetasve të privuar nga liria në proceset gjyqësore. Duke u bazuar në të njëjtin sistem përlllogaritës të distancës (Google Maps) rezulton se një shtetasi që vuan dënimin pranë IIEVP Fushë - Krujë i duhet të udhëtojë dyfishin e distancës kilometrike nëse Gjykata e Krujës shkrihet me Gjykatën e Durrësit. E njëjta distancë përlllogaritet edhe në rastin e një banori në gjendje të lirë në qytetin e Fushë – Krujës, por mundësitë për transportin e shtetasve të privuar nga liria janë të kufizuara. Në këtë drejtim, vlen të evidentohet Rekomandimi nr. 2.3.10 i Udhëzuesit të CEPEJ për Krijimin e Hartave Gjyqësore, sipas të cilit vlerësohet si kriter influencues reduktimi i distancave të udhëtimit për të pandehurit e burgosur të përfshirë në një proces gjyqësor, për arsye ekonomike dhe sigurie. Gjithashtu, vërehet se në analizën e realizuar nuk ka referenca statistikore për një periudhë të caktuar, për vendbanimin e palëve ndërgjyqëse të çështjeve të gjykuara nga Gjykata e Krujës, çka do të shërbente një vlerësimi më realist sa i takon aksesit të tyre pranë Gjykatës në distancën më të afërt.

h. Propozimi për shkrirjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, nuk ka patur në konsideratë numrin e shtetasve të privuar nga liria të akomoduar në IIEVP Kosovë (Lushnje) dhe si ndikon ky ri-organizimin në ndjekjen e çështjeve të tyre të cilat janë duke u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje. Grupi i Punës duhet të mbajë në konsideratë dhe masën e investimit që i është dashur Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për ngritjen dhe vënien në funksion të Qendrave për ofrimin e shërbimeve të Ndihmës Juridike Parësore, të cilat në rastin konkret janë funksionale si në qytetin e Lushnjës dhe në atë të Fierit. Shkrirja e gjykatave nuk duhet të prekë sistemin e ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, pasi në mungesë të Prokurorisë dhe të Gjykatës, për banorët e Lushnjës do të vështirësohej kërkimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas në qytetin e Fierit.

i. Sa i përket propozimit për shkrirjen e Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, Sarandë dhe Përmet, duke shndërruar si seli të Gjykatës qytetin e Gjirokastrës, referuar shkrirjes së propozuar për Gjykatat e Rretheve Kukës dhe Tropojë, sugjerojmë mbajtjen në konsideratë edhe të infrastrukturës rrugore në vendin tonë si dhe kushtet e transportit për në gjykata. Në këtë analizë, është e rëndësishme të merren në konsideratë edhe kriteret e sugjeruara më herët në pjesën metodologjike si kriteri demografik dhe kushtet sociale-ekonomike të banorëve në bashkitë respektive.

j. Propozimi për shkrirjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin me atë të Lezhës, si dhe shkrirjen e Gjykatës së Pukës me atë të Shkodrës, është bazuar në numrin minimal të gjyqtarëve për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore. Gjithashtu, lidhur me kriterin e kohës maksimale që do t'i merrte një qytetari për të mbërritur në këtë Gjykatë vërehet se respektohet distanca prej 2 orësh e mbajtur si standart orientues për vlerësimin e aksesit të qytetarëve. Analiza do të ishte më e plotë dhe vlerësimi më realist nëse nga ana e grupit të punës do të merreshin në konsideratë edhe aspekte të lidhura me shpërndarjen e popullsisë në bashkitë respektive si dhe kushtet sociale ekonomike të banorëve. Këto të dhëna mund të kombinoheshin edhe me numrin dhe natyrën e çështjeve që kanë këta banorë psh gjatë viteve të fundit në Gjykatat që propozohen të shkrihen.

k. Ndër propozimet më shqetësuese të grupit të punës për hartën e re gjyqësore është shkrirja e Gjykatave të Apelit në një Gjykatë Kombëtare të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në vlerësimin tonë, jo domosdoshmërisht “gjykatat më të mëdha” garantojnë akses në drejtësi.

Analiza e disa prej treguesve që janë marrë në shqyrtim për këtë propozim nuk mundëson një vlerësim real, të plotë dhe objektiv të aksesit të qytetarëve në drejtësi, në këtë instancë. Kështu, grupi i punës referon se debati kontradiktor në gjykimin në apel për gjithçka do të mund të shqyrtohet në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore, nuk kërkon praninë e

palëve në seancë siç ndodh zakonisht me gjykimet në shkallë të parë. Megjithatë, lidhur me këtë aspekt, nuk ofrohen minimalisht disa të dhëna statistikore për gjashtë muajt e fundit psh, se sa prej çështjeve janë gjykuar në dhomë këshillimi në Gjykatat e Apelit dhe sa prej tyre kanë patur të nevojshme zhvillimin e seancave gjyqësore. Grupi i punës referon gjithashtu se në pjesën më të madhe të rasteve, gjykimi në apel përfundon si rregull me një seancë, pasi kërkon një përfaqësim më të specializuar (me avokat), duke mos e bërë të domosdoshme praninë e vetë palës. Ky vlerësim kemi mendimin se nuk është realist dhe nuk i përgjigjet të drejtës për mbrojtje efektive. Përveç se është e nevojshme ofrimi i statistikave për këtë indikator, duhet theksuar se është në diskrecion të vetë palëve ndërgjygjëse të vlerësojnë nëse dëshirojnë të jenë prezent në seancë, pavarësisht nëse kanë ose jo një mbrojtës. Në jo pak raste qytetarët ankohen për mbrojtje jo efektive dhe cilësi të dobët të përfaqësimit të çështjeve nga avokatët, veçanërisht për ata që caktohen kryesisht nga gjykata. Gjithashtu, edhe avokatët duhet të përshkojnë një distancë të caktuar nga bashkitë ku ata punojnë drejt Gjykatës Kombëtare të Apelit dhe sa më e gjatë të jetë kjo distancë, aq më shumë rëndon në kostot e avokatit që në shumë raste përballohen dhe paguhen nga qytetarët.

Në funksion të parimeve të menaxhimit të shëndoshë të një gjykate apeli, grupi i punës vlerëson se kërkohet një numër minimal prej 16 gjyqtarësh, për secilën gjykatë apeli. Ky numër sipas vlerësimit të bërë, efektivisht përmbushet vetëm nga një prej gjykatave të Apelit në vend. Në këtë mënyrë është nënkuptuar që një nga indikatorët e vlerësuar nga grupi i punës, në këtë propozim është edhe pamjaftueshmëria e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e apelit. Mgjth, në mënyrë kontradiktore me këtë vlerësim, grupi i punës argumenton se zgjidhja e propozuar do ti japë më shumë mundësi specializimit të gjyqtarëve për drejtësinë penale të të miturve, dhe krijimit të seksioneve civile, duke formuar për herë të parë kolegje të specializuara për çështjet tregtare, familjare, përmbartimore, etj. Natyrshëm lind pyetja se si mund të realizohet ky profilizim, në kushtet kur numri i gjyqtarëve të apelit është tepër i ulët në raport me ngarkesën të cilës ata duhet t'i përgjigjen? Në këndvështrimin tonë, vlerësimi i grupit të punës duhet të shmangte elementë të subjektivizimit që me çdo kusht favorizojnë propozimin e bërë, për të patur një gjykatë të vetme apeli të juridiksionit të përgjithshëm në rang kombëtar. Ky propozim duhej shoqëruar me një analizë objektive dhe të gjithënjashme, me avantazhet dhe disavantazhet që pritet të ketë, për të gjetur zgjidhjen më të balancuar që i përgjigjet treguesve kryesore, e veçanërisht aksesit në drejtësi.

Koha maksimale e përllogaritur për të mbërritur pranë kësaj Gjykate Kombëtare të Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, prej 4 orësh dhe 46 minutash nga Konispoli (skaji më i largët i përllogaritur në rang vendi), vlerësojmë se është një tregues që nuk është llogaritur mbi baza realiste, pasi nuk merr në konsideratë objektivisht kohën që i duhet një qytetari për të udhëtuar me anë të mjeteve të transportit publik. Nisur nga kushtet social-ekonomike të popullatës tonë, përdorimi i mjeteve të transportit publik përfaqëson formën më ekonomike të udhëtimit, por në këtë analizë duhet të mbahen në konsideratë vonesat në realizimin e udhëtimit, cilësia dhe numri i mjeteve që janë në dispozicion për transportin ndër-urban, etj. Gjithashtu, në këtë përllogaritje konstatojmë se Grupi i Punës nuk ka mbajtur në konsideratë kohën e përcaktuar nga ana e gjyqtarit/trupit gjykues për realizimin e një seance gjyqësore, e cila mund të jetë edhe gjatë orëve të mesditës ose pasdrekës, situatë e cila vështirëson ose bën të pamundur kthimin në shtëpi brenda ditës, të qytetarit banues në Konispol apo në Lekbibaj. Sipas një studimi krahasues të reformave të hartave gjyqësore në Europë nga Sciences Po Strasbourg Consulting (2012), shmangiet nga distanca mesatare duhet të përllogariten në formën sa më të arsyeshme të jetë e mundur.

Grupi i Punës ka identifikuar si model pozitiv për këtë propozim, gjykatën e vetme të Apelit Administrativ dhe atë të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Por në këtë rast, vlerësojmë se kriteret përcaktuese nuk mund të analizohen në mënyrë të njëjtë, për shkak të kompetencës lëndore dhe rrjedhimisht natyrës së çështjeve që gjykon secila prej këtyre

Gjykatave. Grupi i Punës duhet të mbajë gjithashtu në konsideratë edhe efektet që ka prodhuar shqyrtimi i çështjeve gjyqësore në nivel vetëm të një gjykate apeli administrativ. Nisur nga vetë Raporti Vjetor 2020 i KLGJ-së³, *backlog* i Gjykatës Administrative të Apelit referuar të dhënave fillim i vitit 2020 ka shënuar 12.810 çështje të mbartura. Nisur nga vetë argumentimi i realizuar nga KLGJ mbi ngarkesën me të cilën përballen gjyqtarët e kësaj gjykate rezulton se, në raport me fillimin e vitit 2019, një vit më pas janë regjistruar rreth 593 çështje të reja ose rreth 4.85% (12.217 çështje në vitin 2019). Ndryshimi midis tre gjykatave të apelit (juridiksioni i përgjithshëm, administrativ dhe ai i posaçëm për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimin të organizuar) duhet parë jo vetëm në aspektin e thjeshtë statistikor për numrin e çështjeve përgjatë një viti dhe stokun, por edhe në drejtim të statusit ekonomik-social të palëve ndërgjyqëse dhe të pandehurve. Kështu, nga monitorimi i organizatave, të çështjeve penale në fushën e korrupsionit rezulton se të pandehurit kanë mundësi më të mira ekonomike të përfaqësohen me avokat privat. E njëjta logjikë vlen edhe për të pandehurit e akuzuar për vepra penale në fushën e krimin të organizuar. Indikator tjetër vlerësimi për dy modelet që janë marrë, është nevoja për të nxjerrë statika për çështjet e natyrës civile (juridiksionit të përgjithshëm) dhe administrative, për raportin e vendimmarrjeve të bazuara në gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi me ato të gjykuara në seanca gjyqësore që kërkojnë prezencën e palëve. Kjo për arsye jo vetëm të natyrës së procesit, por edhe specifikave të tjera që lehtësojnë zhvillimin e procesit në dhomën e këshillimit, si psh për faktin e kalimit të barrës së provës tek organet e administratës publike në çështjet e marrëdhënieve të punës, etj.

Ndërkohë, bazuar dhe në analizën krahasimore të reflektuar në Shtojcën A) të Hartës së Re Gjyqësore të propozuar, janë referuar ndër të tjera, modelet e hartave gjyqësore të ndjekura në Suedi dhe Moldavi. Për të dy këto shtete, reduktimi i numrit të gjykatave është realizuar në mënyrë graduale dhe jo në nivele kaq drastike sikurse është rasti shkrirjes së gjashtë gjykatave në një të vetme. Psh: në rastin e Moldavisë rezulton që të ketë patur një reduktim nga 5 në 4 Gjykata të Apelit, ndërkohë që në rastin e Suedisë reforma e hartës gjyqësore nuk ka ndikuar në numrin e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, i cili mbetet 6. Në Moldavi, kur është ideuar harta e re gjyqësore është kryer një studim i cili ka marrë parasysh, mes të tjerash, edhe kostot financiare për rinovimin, zgjerimin apo zëvendësimin e godinave të gjykatave. Në rastin e vendit tonë, një vlerësim financiar i tillë nuk rezulton të jetë bërë. Kjo situatë mund të ketë edhe pasoja në buxhetin e shtetit, për shkak të investimeve të realizuara tashmë në infrastrukturën fizike dhe logjistike të gjykatave që propozohet të shkrihen. Në kuptimin e oportunitetit të këtyre kostove, ato kanë rënduar tek taksapaguesit (me përjashtim të rasteve kur janë paguar nga donatorë), ndërkohë që do të jenë sërish këta taksapagues që duhet të paguajnë kostot e distancës që krijohet për shkak të shkak të shkrirjes së gjykatave në qytetet ku ata banojnë apo gjykatat e apelit në qarkun e vendbanimit të tyre. Nuk është aspak e drejtë që nën moton e reformimit të sistemit të drejtësisë, qytetarët të vazhdojnë të vuajnë pasojat ekonomike që sjell kjo situatë.

Në Shtojcën B) të raportit të vlerësimit, grupi i punës ka analizuar vendet fqinje si Bosnje-Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia, të cilat kanë një numër më të lartë gjykatash apeli, në raport me propozimin vetëm një në rastin e Shqipërisë. Ndërkohë vende si Danimarka apo Finlanda kanë një numër më të ulët gjykatash, duke garantuar mbulimin e një numri më të lartë banorësh si dhe sipërfaqeje. Për të konkluduar në një analizë të mirëfilltë krahasimore ndërmjet sistemeve të organizimit gjyqësor, do të ishte e nevojshme që Grupi i Punës të bazohej edhe në analizën e standartit ekonomik. Në dallim nga vendin ynë, për shkak të nivelit të lartë të jetësës, shtete si Danimarka, Finlanda apo Suedia kanë mundësinë t'i garantojnë qytetarëve shërbim të aksesit në drejtësi, edhe me një numër më të reduktuar gjykatash. Ky aspekt duhet analizuar edhe në raport me legjislacionin procedural të këtyre

³ Faqe 82

shteteve, hapësirave të përdorimit të teknologjisë së informacionit nga qytetarët dhe nga gjykatat, etj.

Në përfundim, vlerësojmë se propozimi për shkrirjen e 6 Gjykatave të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në një të vetme, përbën një hap i cili nuk është analizuar dhe studiuar në mënyrë objektive dhe të gjithëanshme, mbi bazën e disa kritereve influencues, të cilat mund të cilësohen si dytësore për qendrat e zonave urbane, por për kategori të caktuara njerëzish në nevojë apo për banorët në zonat rurale, janë kritere primare dhe thelbësore.

I. Grupi i punës ka propozuar shkrirje të gjykatave administrative të Shkallëve të Para në rang vendi, duke krijuar në këtë mënyrë vetëm dy Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, me seli në Tiranë dhe Lushnjë. Sikurse dihet, aktualisht, gjykatat administrative të shkallës së parë organizohen në numër dhe për territor të barabartë me atë të gjykatave të apelit civil, pra në 6 qytete dhe konkretisht në Tiranë, Shkodër, Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe Vlorë. Përkundrejt këtij organizimi që kemi aktualisht, vlen të theksohet se propozimi i dy gjykatave të shkallës së parë administrative nuk reflekton numrin dhe territoret e gjykatave të tjera të propozuara në hartën e re gjyqësore (në mënyrë analoge me ato të juridiksionit civil).

Shkrirja e Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Durrës dhe Korçë, duke ia kaluar kompetencat tokësore të këtyre gjykatave, Gjykatës Administrative Tiranë sjell rritjen e shumëfishtë prej rreth 60.84% të kohës maksimale të udhëtimit në krahasim me kohën maksimale të udhëtimit që aktualisht ka Gjykata Administrative e Durrësit në raport me atë të Tiranës (të propozuar si seli), si dhe e përlllogaritur në një rritje rreth 128.2% të kohës maksimale që aktualisht i nevojiten qytetarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për të kërkuar zgjidhjen e çështjeve gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. E njëjta situatë vërehet edhe në rastin e Gjykatës Administrative Lushnje (një tjetër seli e propozuar), ku koha maksimale e udhëtimit është rritur me 25.4% të kohës maksimale të udhëtimit që aktualisht i nevojitet një qytetari për të marrë shërbim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë. Nisur nga kriteri i kohës maksimale të propozuar nga grupi i punës, vërehet se qytetarëve ju nevojitet rreth 4 orë 27' për të mbërritur nga skaji më i largët i Bajram Currit, Margegaj (Tropojë) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe rreth 3 orë 42' për qytetarët e Konispolit, Sarandë për të përfituar nga shërbimet gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë. Ky organizim i ri vlerësojmë se do të përkeqësojë situatën e respektimit të aksesit në drejtësi, duke mos e favorizuar qytetarin në raport me vendbanimin, kushtet infrastrukture të transportit dhe kushtet sociale ekonomike, në të cilat gjendet.

Sa më sipër, Reflektimi i grupit të punës mbi nevojën e rishikimit të raportit të vlerësimit për hartën e re gjyqësore, bazuar në sugjerimet dhe këndvështrimet e përcjella në këtë opinion, vlerësojmë se është i domosdoshëm për të shmangur rrezikun e kolapsit sa i takon aksesit që qytetarët duhet të kenë në organet e drejtësisë. Këto pasoja, sikurse e kemi evidentuar, mund të vijnë si rezultat i mosvlerësimit të indikatorëve të nevojshëm, në mënyrë objektive, realiste dhe të gjithëanshme, për ri-organizimin gjyqësor të gjykatave në vendin tonë.

Në Aneksin A) të këtij opinionimi gjenden të paraqitura në formë tabelore të dhënat rreth kohës maksimale të udhëtimit më të lartë se 2 orë, si dhe rreth kohës maksimale të udhëtimit më të ulët se 2 orë (nisur nga Gjykata e propozuar si seli sipas Grupit të Punës).

Nr.	Gjykata (selia e re e propozuar)	Koha maksimale e udhëtimit më e lartë se 2 orë	Koha maksimale e udhëtimit më e ulët se 2 orë
Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm			
1	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat	2 h e 3 min	
2	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	2 h e 5 min	
3	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë		49 min
4	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	2 h e 24 min	
5	Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe Mat	2 h e 33 min	
6	Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Kavajë dhe Krujë		1 h e 24 min
7	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Lushnjë		1 h e 5 min
8	Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Sarandë dhe Përmet		1 h e 57 min
9	Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe Tropojë	2 h e 31 min	
10	Gjykatat e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe Pogradec	2 h e 6 min	

11	Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Kurbin		1 h e 30 min
12	Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Pukë	2 h e 56 min	
Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm			
1	Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	4 h e 56 min (Konispol) 4 h e 10 min (Bajram Curri, Margegaj)	
Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë			
1	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Korçë	4 h e 27 min	
2	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjirokastrë	3 h e 42 min	

Organizatat nënshkruese:

1. **Civil Rights Defenders (CRD)**
2. **Fondacioni Shqipëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (ADRF)**
3. **Instituti për Studime Politike (ISP)**
4. **Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA/ECPAT Albania)**
5. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ)**
6. **Qendra Europiane**
7. **Qendra e Studimit të Politikave Evropiane për Zhvillimin Rajonal dhe Lokal**
8. **Komiteti Shqiptar i Helsinkit**
9. **Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)**